

ROLI I TË DHËNAVE STATISTIKORE NË HARTIMIN E
POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK NË SHQIPËRI

Ilir Ciko

Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit

ROLI I TË DHËNAVE STATISTIKORE NË HARTIMIN E POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK NË SHQIPËRI

1. PAK FJALË RRETH PLANIFIKIMIT FINANCIAR E ATIJ EKONOMIK

Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, strukturat e administratës shqiptare dhe si pjesë e tyre edhe institucionet, që trajtojnë çështjet që lidhen me statistikën, kanë pësuar një zhvillim të shpejtë dhe radikal duke u përballur me dy faktorë të rëndësishëm:

- (i) ndryshimin dhe përshtatjen me modelet dhe konceptet e ekonomisë së tregut të zhvilluara në Europën Perëndimore dhe më gjerë, si dhe,
- (ii) ekzistencën dhe efektin e strukturave dhe formave të trashëguara të institucioneve, që i përgjigjen sistemit të centralizuar, të cilat megjithë ndryshimet e diktura nga nevojat e kohës, ende ruajnë elemente të paraardhësve të tyre dhe që për më tepër, nuk kanë pësuar gjithnjë të njëjtin ritëm zhvillimi.

Ndërsa faktori i parë ka qenë përcaktues dhe kryesor për formimin dhe funksionimin e këtyre strukturave në shërbim të ndërtimit dhe të zhvillimit të ekonomisë së tregut, pasojat e efekteve të faktorit të dytë jo vetëm që nuk mund të neglizhohen, por në të kundërt, kanë krijuar vazhdimisht probleme në funksionimin e shtetit në një ekonomi tregu.

Në një kohë kur dhe në shtetet më të zhvilluara perëndimore, roli i shtetit në drejtim të organizimit dhe të funksionimit të ekonomisë është i padiskutueshëm, rasti i Shqipërisë, për shkak të dy faktorëve të mësipërm si dhe konfondimit të shpeshtë të tyre, lë mjaft për të dëshiruar dhe kryesisht është i përqëndruar për atë pjesë të ekonomisë, që në gjuhën e përditshme njihet me ekonomi 'shtetërore', ose siç përmendet shpesh, 'publike'.

Duke mos u ndalur në një nga funksionet më të rëndësishme të shtetit, që lidhet me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, - kjo temë i përket kryesisht Ministrisë së Financave si dhe strukturave që lidhen me të -, mund të përmendim se një punë mjaft e mirë është bërë, veçanërisht në vitet e fundit, në drejtim të përsosjes së planifikimit dhe zbatimit financiar në harmoni me nevojat e strukturave buxhetore si dhe të investimeve prioritare të përcaktuara nga Qeveria Shqiptare. Miratimi i një ligji të posaçëm organik për buxhetin e shtetit si dhe bashkëpunimi me organizma të specializuar ndërkombëtarë në këtë drejtim, krahas ndjekjes së një politike të konsoliduar makroekonomike dhe fiskale, ka bërë të mundur që treguesit kryesorë makroekonomikë të vendit të jenë relativisht të qëndrueshëm dhe zhvillimi i ekonomisë së vendit të jetë i stabilizuar.

Megjithatë, problemi kryesor që bie në sy përse i përket trajtimit të kësaj çështjeje është, pa dyshim, mungesa e një strategjie për përcaktimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Mund të duket disi paradoksale ekzistenca e një sistemi planifikues financiar, ndërkohë që mungon, thuajse plotësisht, planifikimi ekonomik, i cili në kushte normale duhet t'i paraprijë të parit. Është pikërisht ndeshja e dy faktorëve të mësipërm, që bën të mundur që roli i planifikimit ekonomik të jetë ende i zbehtë duke krijuar dashur pa dashur probleme të rëndësishme edhe në planifikimin financiar.

Një interpretim i tillë, në kushtet e Shqipërisë, do të mund të kuptohej edhe si një tendencë drejt centralizimit të ekonomisë, por këtu nuk është fjala për kontrollin e shtetit mbi ekonominë, sikurse ndodh në ekonominë socialiste, por për zbatimin e një roli aq të nevojshëm aktiv të shtetit në drejtim të përcaktimit të prioriteteve të zhvillimit si dhe të promovimit të degëve të ekonomisë, që ofrojnë avantazhe krahasuese me ato të vendeve fqinjë. Që kjo gjë të kryhet, është e nevojshme që të forcohet roli i shtetit në drejtim të krijimit të ambientit të përshtatshëm për zhvillimin e planifikimit ekonomik në përputhje me normat dhe kërkesat e ekonomisë së tregut, gjë që ndodh rëndom në pjesën dërrmuese të vendeve të zhvilluara, ku lidhur me planifikimin, theksohet se:

Failing to plan is planning to fail'. (Të dështosh për të planifikuar është të planifikosh për të dështuar.) Dhe për të arritur këtë synim, roli i statistikave dhe përdorimi efektiv i tyre, natyrshëm, është i domosdoshëm.

2. FLUKSI I INFORMACIONIT QË MERRET NGA SHOQËRITË PUBLIKE

Duke trashëguar një ekonomi të centralizuar, një nga hapat e shpejtë dhe më të suksesshëm të kryer nga qeveritë shqiptare në vitet 90' ishte privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe krijimi i kushteve për zhvillimin e sektorit privat. Tashmë, ky i fundit nga inekzistent dhjetë vjet më parë, dominon tërësisht ekonominë shqiptare. Statistikat tregojnë se, aktualisht, mbi 98 për qind e ndërmarrjeve në Shqipëri janë me pronësi private dhe se numri i ndërmarrjeve shtetërore, si pasojë e procesit të privatizimit dhe të falimentimit të atyre degëve, që nuk iu përgjigjen dot ndryshimeve strukturore në ekonominë shqiptare, vjen gjithmmonë duke u reduktuar. Megjithatë, shteti ende ruan një pjesë të konsiderueshme pronësie në një sërë degësh të ekonomisë si minierat, industria, transporti, nafta dhe gazi etj., madje duke gëzuar dhe të drejtën e monopolit në degë të tjera të rëndësishme si telekomunikacionet dhe energjia.

Si pasojë e ruajtjes së pronësisë shtetërore mbi këto degë, aktiviteti i ndërmarrjeve përkatëse është i drejtuar dhe i kushtëzuar nga roli i shtetit mbi to. Megjithëse ka ndryshime esenciale nga ekonomia e dikurshme socialiste, - kjo diktuar jo vetëm nga ndryshimet institucionale dhe politikat e ndjekura nga organet e qeverisjes, por dhe për shkak të përballjes në të gjitha aspektet me konkurrencën e sektorit privat dhe të atij të huaj, - një pjesë e konsiderueshme e aktivitetit të këtyre ndërmarrjeve drejtohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga organet shtetërore të varësisë.

Në ç'mënyrë është i organizuar ky 'kontroll', dhe cili është fluksi i informacionit statistikor, që merret nga aktiviteti i shoqërive shtetërore? Pa hyrë në aspektet organizative të administrimit të këtyre shoqërive, ku natyrshëm shteti sikurse dhe çdo pronar privat ka të drejtë të plotë për të vendosur (emërimin e organeve drejtuese, numrin e fuqisë punëtore, sistemin e pagave dhe shpërblimeve etj.), duke u ndalur në aspektet e treguesve ekonomikë, aktualisht, shteti planifikon në mënyrë të rregullt, zakonisht mbi bazë vjetore, këto elemente të rëndësishme të aktivitetit të shoqërive:

- të ardhurat vjetore;
- shpenzimet e aktivitetit;
- fitimin e shoqërisë;
- derdhjet (kontributet) në buxhetin e shtetit;
- dividendin për shtetin;
- investimet që kryhen nga shoqëritë.

Është e qartë që elementet e mësipërme, edhe pse jo të shumta në numër, janë sintezë e një plani të detajuar biznesi, që sot quhet program zhvillimi, i cili paraqitet nga shoqëritë shtetërore për të marrë miratimin përkatës nga pronari i vetëm që është shteti. Kështu, pjesa më e madhe e këtyre elementeve (përfshirë fitimin dhe dividendin), zërthehen në pjesë të rëndësishme përbërëse të cilat, gjithashtu, miratohen në trajtën e zgjeruar të tyre. Për të dhënë një shembull, miratimi i nivelit të investimeve që kryhen, bëhet jo vetëm si një shumë totale, por kjo e zërthyer në elementet e tyre sipas destinacionit, burimit të financimit etj.. Vlen të theksohet se krahas këtyre elementeve, një vend të rëndësishëm në miratimin përkatës zënë dhe drejtimet dhe objektivat strategjikë të aktivitetit të shoqërive, nga të cilat burojnë dhe shifrat konkrete të treguesve të zhvillimit.

Për të ilustruar konkretisht këtë fakt, në tabelën pasardhëse jepet një shembull hipotetik i strukturës përmbledhëse të miratimit të planit të zhvillimit të shoqërive publike. Sikurse vihet re, treguesit e mësipërm janë të ngjashëm dhe jo shumë larg objektivave, që dhe shoqëritë private përcaktojnë për administratorët e tyre. Mbi performancën e realizimit të tyre varet dhe masa e shpërblimit ose 'ndëshkimit' që administratorët e shoqërive marrin, edhe pse praktika, në përgjithësi, ka treguar që ndjeshmëria e pronarit shtet krahasuar me atë privat, për këtë rast është e ndryshme.

Gjithësesi, edhe pse kemi të bëjmë me pronësi shtetërore, forma dhe përmbajtja e këtyre elementeve të programit të zhvillimit, me plot bindje, mund të thuhet se është shumë më afër tipareve të një ekonomie tregu se sa të një ekonomie të centralizuar. Kjo argumentohet dhe me faktin që veç miratimit të këtyre objektivave si dhe matjes së performancës së tyre, në përgjithësi, ndërhyrja e shtetit në operacionet e përditshme të shoqërive është tejte e kufizuar, përfshirë rastet e veçanta, që e kërkojnë këtë ndërhyrje (rast tipik për shembull është aktiviteti i KESH-it, i cili përballet me vështirësi të rëndësishme kombëtare ku bashkërendimi i punës me institucionet qendrore është i domosdoshëm).

Ndërsa treguesit e trajtuar më sipër shërbejnë si objektiva të punës së shoqërive shtetërore pavarësisht nga natyra e aktivitetit të tyre, përgjatë gjithë vitit këto shoqëri dërgojnë pranë ministrive përkatëse, në mënyrë të rregullt, informacion mbi aktivitetin e tyre. Në mënyrë të përmbledhur, fluksi i informacionit periodik, që dërgohet për këtë qëllim, konsiston në:

- raportim mbi performancën e treguesve financiarë të përcaktuar në programin e zhvillimit;
- evidenca statistikore, që lidhen me aktivitetin e shoqërisë.

Përsa i përket elementit të parë të informacionit, atij të raportimit të treguesve ekonomikë dhe financiarë, kjo kryhet në mënyrë periodike (zakonisht me bazë tremujore) nga të gjitha shoqëritë shtetërore. Informacioni dërgohet dhe në raste të veçanta, kur kjo kërkohet ose kur është e nevojshme të ndërhyhet, nga ministria përkatëse, për problemet me të cilat mund të haset shoqëria gjatë aktivitetit të saj. Vlen të theksohet, që ky informacion përmban vetëm tregues ekonomik-financiarë në shifra, të cilat janë të njëjta në formë dhe lejojnë bazë krahasimi për të gjitha shoqëritë shtetërore. Në fillim të çdo viti financiar, shoqëritë dërgojnë në ministri për miratim dhe pasqyrën përfundimtare të rezultatit financiar të vitit të mëparshëm (bilancin). Një botim i vitit të kaluar pasqyron një përmbledhëse të të gjitha bilanceve të shoqërive shtetërore për tre vitet e fundit, ndërkohë që është në përgatitje botimi i ri për vitin 1999.

Ndryshe nga treguesit e mësipërm, elementi i dytë i informacionit, të përgatitur nga shoqëritë për ministrinë (përfshirë më pas dhe INSTAT), ka të bëjë me aktivitetin specifik të shoqërive. Kështu, nga të gjitha shoqëritë dhe ndërmarrjet shtetërore, informacioni periodik, i cili dërgohet pranë ministrive, zakonisht çdo dy muaj, përmban:

- realizimin e zërave kryesorë të prodhimit;
- prodhimin mall i shitur;
- treguesit e importit dhe eksportit;
- volumin e shërbimeve;
- treguesit teknikë;
- treguesit e punës;
- të tjera;

Ky informacion, i cili është specifik për secilën shoqëri (në përgjithësi ndërmarrjet dhe shoqëritë e mbetura shtetërore kanë aktivitete të ndryshme nga njera-tjetra), - ka një rëndësi të dorës së parë, jo vetëm përse i përket hartimit të programeve të zhvillimit të shoqërive, por në rradhë të parë për të kuptuar realisht se ç'ndodh me aktivitetin e shoqërive (që në mjaft raste identifikohen dhe me sektorin përkatës të ekonomisë si për shembull KESH, Albtelekom etj.) dhe për rrjedhim edhe për ndërtimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit, të cilat shoqërohen me ndërtimin e politikave përkatëse si dhe me zbatimin në praktikë të tyre. Në këtë këndvështrim, kuptohet edhe më mirë se përse në ata sektorë të ekonomisë ku shteti ka rol dominues, janë kryer ose janë në proces, strategji të tilla zhvillimi, të cilat kuadrojnë në mënyrë të plotë gjendjen aktuale të sektorit përkatës si dhe zhvillimin e tij në të ardhmen. Për të ilustruar përmbajtjen e këtij informacioni, në tabelën më pas, paraqitet një shembull konkret i informacionit të përpunuar nga shoqëritë publike. Një informacion i plotë, i strukturuar dhe i krahasueshëm në vite, për të gjitha shoqëritë publike, ndodhet i publikuar në faqen e Internetit të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (www.mepp.gov.al).

3. STATISTIKAT EKONOMIKE: NDRYSHIMET NDERMJET BURIMEVE SHTETERORE DHE ATYRE PRIVATE

Informacioni i trajtuar më sipër dërgohet rregullisht nga thuajse të gjitha shoqëritë publike pranë ministrive të varësisë dhe INSTAT. Në këtë mënyrë, të dhënat e sektorit shtetëror janë të strukturuar, të besueshme dhe periodike. Shoqëritë dhe ndërmarrjet shtetërore kanë për detyrë dërgimin e këtij informacioni. Zbatimi i këtij detyrimi shoqërohet dhe me masat përkatëse ligjore dhe administrative, të cilat janë lehtësisht të identifikueshme dhe të zbatueshme. Informacioni i dërguar shërben dhe si sinjal për vendimmarrjen, nga ana e organeve të varësisë si dhe për hartimin e politikave sektoriale të zhvillimit, ndaj mbi këtë bazë, shoqëritë publike janë të interesuara për transmetimin e saktë të informacionit, që ato gjenerojnë.

Por, që hartimi i këtyre politikave të jetë i bazueshëm në realitetin e plotë të ekonomisë shqiptare, është e domosdoshme që informacioni të merret nga të gjitha njësitë përbërëse të sektorëve përkatës. Ndërsa vetëm në dy-tre sektorë të ekonomisë shteti ende dominon pronësinë, në pjesën më të madhe të saj, është sektori privat që ka dhe peshën kryesore të aktivitetit.

Pyetja që shtrohet në këtë rast është se, a është i gatshëm sektori privat të disponojë, me të njëjtën korrektesë dhe saktësi, informacionin për institucionet qeveritare, sikurse dhe ndërmarrjet apo shoqëritë shtetërore? Eksperienca e deritanishme, fatkeqësisht, tregon të kundërtën. Të dhënat që merren nga sektori privat, mund të kategorizohen në 4 drejtime kryesore: (i) të dhënat

statistikore që i dërgohen INSTAT, (ii) të dhënat që disponohen nga zyrat e tatimeve dhe doganave, (iii) të dhënat që disponohen nga institucionet e tjera në rastet e licencimit të aktivitetit, kur kjo gjë kërkohet, dhe (iv) burime të tjera.

Analizimi i të dhënave nga burimet e mësipërme dëshmon kryesisht për parregullsi të këtij informacioni, mospërputhje në pjesën më të madhe të tij, frekuencë të çrregullt të dërgimit të informacionit etj., etj.. Shkaqet që shtyjnë ndërmarrjet dhe shoqëritë private të injorojnë ose të deformatojnë informacionin përkatës janë të shumëllojshme dhe varen kryesisht nga moskuptimi i rëndësisë së përdorimit të informacionit nga strukturat shtetërore, mosbesimi ndaj këtyre strukturave, konfidencialiteti i informacionit, konkurrenca në treg, angazhimi i personelit të nevojshëm dhe shpenzimet e tjera, që lidhen me përgatitjen e këtij informacioni, niveli i formimit menaxherial i strukturave administrative të këtyre shoqërive etj.

4. NDIKIMI I PROCESIT TË PRIVATIZIMIT NË INFORMACIONIN QË MERRET NGA SHOQËRITË TREGTARE

Është një fakt i pamohueshëm që procesi i privatizimit ka ndikuar pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Nëpërmjet progresit të arritur në privatizim, veçanërisht gjatë viteve të fundit, i është hapur rruga investimeve të rëndësishme nga ana e sektorit privat, të cilat kanë sjellë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, heqjen e mbështetjes së shtetit për ndërmarrjet shtetërore, zhvillimin e konkurrencës dhe liberalizimit të tregut etj..

Sipas statistikave të qeverisë procesi i privatizimit ka përfunduar tashmë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ku përfshihen sektorë të tillë si bujqësia, industria e lehtë dhe ushqimore, transporti, një pjesë e mirë e minierave etj.. Në programin e privatizimit mbeten ende shoqëritë publike të sektorëve strategjikë, që përmbajnë turizmin, minierat e mëdha të vendit (pjesa më e madhe e tyre nuk funksionon ose rezulton me humbje), Albtelecomin, industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të naftës, energjinë elektrike etj..

Gjithësesi, me përfundimin e privatizimit të rreth 465 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të trashëguara nga viti 1997 (në total rreth 13,000 objekte që nga viti 1993), numri i shoqërive, që vazhdojnë të mbajnë pronësi shtetërore është reduktuar nën 100, duke qenë i papërfillshëm me zhvillimin dhe përmasat e sektorit privat. Duke konsideruar programin qeveritar për një privatizim të plotë të ekonomisë, në një periudhë afatmesme do të jemi përpara situatës kur e tërë ekonomia shqiptare do të zotërohet nga sektori privat dhe ku shtetit nuk do t'i mbetet thuajse asgjë në zotërim nga shoqëritë e sotme publike.

Rezultatet e procesit të privatizimit reflektohen qartë dhe në peshën që zënë në prodhimin e përgjithshëm brut kombëtar, shoqëritë publike. Kështu, në vitin 1992 (kur privatizimi sapo kishte filluar), prodhimi i këtyre shoqërive zinte rreth 28 për qind të PPB. Me kalimin e viteve, PPB është rritur si pasojë e zhvillimit të ekonomisë, ndërkohë që prodhimi nga shoqëritë publike është reduktuar në vlerë absolute dhe veçanërisht në peshën që zë si pjesë përbërëse e PPB. Në vitin 1999, shoqëritë publike dhanë rreth 4 për qind të PPB. (Shih tabelën më poshtë).

Viti	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
<i>mln.leke</i>	53.2	125.3	188	225	281	342	461	506.2
<i>Te ardhurat e shoqërive publike (000mln.leke)</i>	17.4	23.9	28.2	34.8	40.7	41.4	50.5	49.3
<i>Ne % te GDP</i>	33%	19%	15%	15%	14%	12%	11%	10%
<i>Prodhimi mall i shitur (Publike, ne (000mln.leke)</i>	15	21	20.6	26	28	24	24	21
<i>Ne % te GDP</i>	28%	17%	11%	12%	10%	7%	5%	4%

Është interesante se ky fakt ilustron jo vetëm nëpërmjet shifrave të privatizimit, por, njëkohësisht, dhe me anë të ndryshimeve institucionale, që kanë pësuar nivelet e larta të qeverisjes në Shqipëri.

Kështu, pronësia e shtetit mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë publike tashmë përfaqësohet nga një ministri e vetme, e cila përmban brenda saj aktivitetin e mëparshëm të disa ministrive, asaj të Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjitike, Privatizimit dhe Departamentit të Postë - Telekomunikacioneve.

Progresi i privatizimit, i analizuar përkrah vështirësive që u përmendën më lart, që lidhen me problemet që aktualisht sektori privat ka në prodhimin dhe transmetimin e informacionit statistikor, do të shpjegjë, mjaft shpejt, në reduktimin e plotë të informacionit, që disponohet nga shoqëritë publike duke krijuar një rrezik potencial dhe tepër të rëndësishëm për institucionet që e kërkojnë dhe e përdorin këtë informacion.

Aktualisht, ky është një problem i njohur për institucionet shqiptare, të cilat kanë probleme në marrjen e informacionit jo vetëm nga sektori privat, por dhe nga ato njësi që deri pak kohë më parë kanë qenë shtetërore dhe si të tilla dispononin dhe informacion përkatës, ndërsa tani janë të privatizuara.

5. PËRDORIMI I INFORMACIONIT ME SYNIM HARTIMIN E POLITIKAVE SEKTORIALE TË ZHVILLIMIT

Problemi i trajtuar më sipër nxjerr qartë në pah nevojën e ristrukturimit të domosdoshëm të mënyrës së marrjes së informacionit nga njësitë ekonomike të vendit dhe sidomos nga ndërmarrjet dhe shoqëritë me kapital privat. Për këtë qëllim, është i nevojshëm rikonceptimi i këtij procesi të rëndësishëm duke konsideruar faktorët dhe sugjerimet e mëposhtme:

5.1 PËRDORIMI I INFORMACIONIT STATISTIKOR NGA STRUKTURAT SHTETËRORE NË SHËRBIM TË KRIJIMIT TË NJË AMBIENTI TË PËRSHTATSHËM PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT

Është e domosdoshme që biznesi privat të ndërgjegjësohet për faktin që, informacioni i kërkuar nga institucionet shtetërore nuk nevojitet për të mbajtur në punë struktura burokratike apo për të ushtruar kontroll mbi aktivitetin privat, por në rradhë të parë, për të bërë të mundur hartimin e politikave të zhvillimit, të cilat janë plotësisht të ndërvarura nga ky informacion. Pa bashkëpunimin e të gjitha palëve, është praktikisht e pamundur të ndihmohen ato degë të ekonomisë, të cilat mund të ofrojnë avantazhe krahasuese në vend.

Në këtë mënyrë, hartimi i strategjive sektoriale të zhvillimit, përcaktimi i qëndrimit në negociatat mbi tarifën doganore, rreth marrëveshjeve të tregtisë së lirë, rreth sistemit fiskal, që aplikohet mbi degë të ndryshme të biznesit etj. do të jetë i bazuar mbi të dhëna reale dhe që pasqyrojnë plotësisht gjendjen dhe zhvillimin e ekonomisë shqiptare. Praktika ka treguar që në rastet e negociimit të tarifave doganore (me vendet fqinje ose në kuadër të OBT), qëndrimi i mbajtur është bazuar kryesisht në të dhënat e sektorit publik dhe në treguesit e import-eksportit, duke mos disponuar të dhëna rreth aktivitetit të sektorit privat në të njëjtën fushë aktiviteti. Ndërkohë, politika tarifore prek në të njëjtën mënyrë si sektorin publik, ashtu dhe atë privat.

Jemi të mendimit se tërheqja e informacionit nga sektori privat duhet të shmangë plotësisht aplikimin e sistemit të licencimit për këtë qëllim. Në përgjithësi, përdorimi i sistemit të licencimit vështirëson komunikimin shtet-privat duke formalizuar fluksin e informacionit dhe si rrjedhim duke kompromentuar besueshmërinë e tij.

Përdorimi i suksesshëm i strukturave të bashkëpunimit të institucioneve shtetërore me biznesin privat është një urë e rëndësishme pozitive për arritjen e këtij qëllimi. Institucionalizimi i komitetit për zhvillimin e biznesit, aktivizimi i biznesit privat në vendimmarrjen politike, integrimi i shoqërisë civile dhe përfaqësimit të biznesit në kuadër të kompaktit të investimeve ka dhënë, së fundi, rezultate konkrete dhe tepër të rëndësishme për hartimin e politikave ekonomike të qeverisë.

5.2 HARMONIZIMI I INFORMACIONIT STATISTIKOR, QË MERRET NGA NJËSITË EKONOMIKE DHE I METODOLOGJISË SË PËRPUNIMIT TË TIJ

Mendojmë se eksperiencia e krijuar me shoqëritë publike është një përvojë e mirë në drejtim të përdorimit të metodave të ngjashme dhe me shoqëritë private. Në këtë drejtim, një ndihmesë të rëndësishme mund të japin institucionet e specializuara ndërkombëtare, të cilat aplikojnë programe të tilla dhe në vende të tjera, të cilat janë në fazën e tranzicionit.

5.3 RISTRUKTURIMI I INSTITUCIONEVE SHTETËRORE QË TRAJTOJNË POLITIKAT SEKTORIALE

Aktualisht, nuk ka një strukturë të mirëfilltë që të bëjë të mundur përpunimin e një vizioni të qartë mbi zhvillimin e ekonomisë shqiptare.

- Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit ushtron të drejtën e shtetit si pronar i pronës publike, kryen privatizimin e kësaj prone dhe administron një pjesë të rëndësishme të sektorëve (publike) të ekonomisë së vendit. Marrëdhëniet me sektorin privat janë kryesisht të orientuara në drejtim të procesit të privatizimit të pronës publike dhe fare pak në drejtim të ndjekjes së problemeve me të cilat ai haset. Informacioni, që disponohet nga ky sektor është i kufizuar në rastet kur kjo ministri aplikon licencat për ushtrim aktiviteti në sektorë të caktuar dhe shkalla e besueshmërisë së informacionit nuk njihet saktë.
- Ministria e Financave analizon treguesit makroekonomikë si dhe merret me hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit. Burimi më i sigurt i informacionit nga kjo ministri janë zyrat e tatimeve dhe të doganave, por informacioni që këto zyra disponojnë është i strukturuar për nevojat e tyre dhe përgjithësisht i rezervuar për to.
- Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë disponon informacion të kufizuar nga sektori privat dhe kryesisht koordinon punën e institucioneve të tjera në funksion të hartimit të politikave tregtare.
- Ministrinë e tjera të linjës (bujqësisë, transportit etj.) disponojnë informacion rreth aktivitetit të sektorit privat në fushat respektive, por ky informacion nuk përpunohet së bashku me pjesën nga sektorët e tjerë të ekonomisë.
- Banka e Shqipërisë, në mënyrë të ngjashme me Ministrinë e Financave, është e kufizuar në treguesit integralë të ekonomisë dhe mbështetet kryesisht në informacionin që disponon nga strukturat e tjera shtetërore.
- Instituti i Statistikave mbledh informacionin më të rëndësishëm nga subjektet private, por është e nevojshme që të përmirësohet sistemi i informacionit për të shmangur problemet e trajtuara më sipër si dhe të koordinohet puna me institucionet e tjera për të strukturuar nevojat e përdorimit të këtij informacioni.
- Dhomat e tregtisë disponojnë informacion tepër të kufizuar dhe që, përgjithësisht, nuk reflekton si duhet gjendjen reale të ekonomisë shqiptare.

Nga ky vështrim i shkurtër mbi institucionet shqiptare kuptohet që informacioni statistikor, që merret nga njësitë ekonomike është mjaft heterogjen dhe nuk përpunohet në një institucion qendror, i cili mund të koordinojë punën, të harmonizojë statistikën dhe të hartojë politikën e zhvillimit të ekonomisë së vendit. Që këtë, duket i këshillueshëm ndërtimi i një institucioni të ri, që mund të kryejë këtë rol, i cili mund të jetë pranë funksionit të një Ministrie të Ekonomisë Kombëtare, ose në të kundërt të një institucioni pranë Këshillit të Ministrave. Një konkluzion i tillë mund t'i sugjerohet Qeverisë Shqiptare për shqyrtim në të ardhmen.